



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.66 Prot.

Datë 18 /12/2007

VENDIM

Nr.66, datë 18/12/2007

Për Vendosje gjobe për Shkelje të Lehtë

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PËRPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18 / 12 /2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Përcaktimin e masës së gjobës për ndërmarrjet prodhuese të betonit që nuk kanë sjellë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, neni 33 pika 1, neni 73, pika 1, germa, a) dhe neni 80.
- Kodi i Procedurave Administrative.

Palët të cilave i është kërkuar informacion:

1. “Alba-Beton” sh.p.k., Rr.“Arkitekt Sinani”, Pall 220/1, no. 7, Tiranë
2. “ANI” sh.p.k., Rr. “Qemal Stafa”, Nr 31 Tiranë
3. “Alban-Tirana Co” sh.p.k., Rr.“Komuna e Parisit”, Pall 4, Kati 2 Tiranë.
4. “Beton Ekspres”, Pranë fabrikës së tullave Vorë, Tiranë.
5. “Delia Group “sh.p.k., Rr.”Irfan Tomini” Nr. 7 Tiranë.
6. “Eurovini” sh.p.k., Rr “Ismail Qemali” Tiranë
7. “Eurobeton 2005” sh.p.k., Km.1, Autostrada Tiranë – Durrës.
8. “Euro Lines” sh.p.k., Kthesa Kamzës Tiranë.
9. “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k., Km. 20 Vorë, Tiranë

10. "Halili" sh.p.k., Rr. "Qemal Stafa" pranë porcelanit, Tiranë.
11. "Ital-Beton Construction", Lundër, Tiranë.
12. "Kirchberger Albania" sh.p.k., Bul: "Zogu i Parë" Tiranë.
13. "K.D.K" sh.p.k., Rr. "Dervish Hima", Kulla Nr.1, Tiranë
14. "Qarri 02" sh.p.k., Zall Herr, Tiranë
15. "Sina 98" sh.p.k., Shkozë, Tiranë
16. "Shkodra Beton" sh.p.k., Rr. "Durrësit", ish serat, Tiranë
17. "Best Construction Alb" sh.p.k. (BestStar), Rr. "Kavajës", Tirana Tower, Kati 6, Tiranë
18. "Edil Al-It" sh.p.k. (Tirana Beton), Rr. "Perlat Rexhepi", Pall. 14-kat, Kati 2, Tiranë

KOMISIONI I KONKURENCËS

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës i ka kërkuar informacion ndërmarrjeve: "Alba-Beton" sh.p.k., "ANI" sh.p.k., "Alban-Tirana Co" sh.p.k., "Beton Ekspres", "Delia Group" sh.p.k., "Eurovini" sh.p.k., "Eurobeton 2005" sh.p.k., "Euro Lines" sh.p.k., "Ferro Beton & Construction Co" sh.p.k., "Halili" sh.p.k., "Ital-Beton Construction", "Kirchberger Albania" sh.p.k., "K.D.K" sh.p.k., "Qarri 02" sh.p.k., "Sina 98" sh.p.k., "Shkodra Beton" sh.p.k., "Best Construction Alb (BestStar)" sh.p.k., "Edil Al-It" sh.p.k. (Tirana Beton)", me anë të shkresës nr. 487 datë 25.09.2007, "Njoftim për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkesë për Informacion".

Ndërmarrjet "Alban-Tirana Co" sh.p.k., "Beton Ekspres", "Ferro Beton & Construction Co" sh.p.k., "Halili" sh.p.k., "Ital-Beton Construction", "Kirchberger Albania" sh.p.k., "Qarri 02" sh.p.k., "Shkodra Beton" sh.p.k., "Best Construction Alb (BestStar)" sh.p.k. nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion sipas shkresës, nr 487 datë 25.09.2007, "Njoftim për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkesë për Informacion" bashkangjitur formularin, në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky veprim përbën shkelje të lehtë në bazë të nenit 73, pika 1, germa a) të ligjit nr. 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 73, pika 1, germa a, dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së gjobës për shkelje të lehtë ndaj ndërmarrjeve të mëposhtme me 0.1 % të xhiros vjetore të vitit 2006.

Ndërmarrja	Masa e Gjobës
"ALBAN - TIRANA CO"	447915
BEST CONSTRICTION ALB	235367
BETON EKSPRES	178534
FERRO BETON & CONST.	436959
HALILI	172519
ITAL-BETON CONST.	201086
KIRCHBERGER - ALBANIA	508279
QARRI - 02	169652
SHKODRA BETON	396974

2. Ngarkohet Policia Tatimore për vjeljen e këtyre gjobave në vleftat e përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 18.12.2007

ANËTARËT

Lush PËRPALI
()

Zv/Kryetar

Servete GRUDA
()

Anëtare

Koço BROKA
()

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE